

*Ky manual është përgatitur në kuadër të projektit: “Promovimin e aktivizmit dhe pjesëmarrjen e publikut dhe shoqërisë civile në Reformën e Sistemit të Drejtësisë” të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri, në kuadër të Programit Matra për Shtetin e së Drejtës.*

Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri.

# **MANUAL** 2017

PËR INFORMIMIN E QYTETARËVE  
LIDHUR ME REFORMËN NË DREJTËSI

## MANUAL 2017

PËR INFORMIMIN E QYTETARËVE LIDHUR ME REFORMËN NË DREJTËSI

*Përgatitën manualin:*

**Etilda Gjonaj** - Eksperte, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Znj. Etilda Gjonaj** - Eksperte, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

*Përgatitën për botim:*

**Klejda Ngjela** - Menaxhere projektsh në KShH

**Irismilda Gjonaj** - Asistente projektsh në KShH

*Supervizim:*

**Erida Skëndaj** - Drejtore Ekzekutive e KShH- së

*Autor:* © **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij

*Nëse jeni të interesuar për këtë manual, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:*

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati "Tekno Projekt" Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: +355 4 2233671 Cel: +355 682023699

[https:// www.facebook.com/KomitetishqiptarIHelsinkit](https://www.facebook.com/KomitetishqiptarIHelsinkit)

E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al);

**[www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**

# TABELA E LËNDËS

HYRJE

## KAPITULLI I

VETTINGU – NJË MASË E JASHTËZAKONSHME PËR REFORMIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË.....8

## KAPITULLI II

ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË.....16

- KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR.....17
- KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË.....20
- INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË.....22
- KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI.....23

## KAPITULLI III

GJYKATA KUSHTETUESE.....26

## KAPITULLI IV

PUSHTETI GJYQËSOR.....36

## KAPITULLI IV

PROKURORIA.....44

## KAPITULLI VI

INSTITUCIONET KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR.....50



## **LISTA E SHKURTIMEVE TË EMRAVE- AKRONIME**

**ONM** - Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

**KLJGJ** - Këshilli i Lartë Gjyqësor

**KLD** - Këshilli i Lartë i Drejtësisë

**KLP** - Këshilli i Lartë i Prokurorisë

**RSH** – Republika e Shqipërisë

**GJK** – Gjykata Kushtetuese

**SPAK** – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

## HYRJE

***“Si gjyqtar nuk kam platformë politike. I djathtë dhe i majtë, fetar dhe laik, i pasur dhe i varfër, burra dhe gra, i paaftë dhe i aftë, të gjithë janë qenie njerëzore. Unë do të mbroj dinjitetin e secilit. Nuk synoj pushtet. Nuk kërkoj të sundoj. Unë i njoh zinxhirët që më lidhin si gjyqtar. Sa herë që hyj në sallën e gjykimit, hyj me ndjenjën e thellë që ndërsa gjykoj pres edhe të gjykohem.”***

(Aharon Barak, ish kryetari i Gjykatës së Lartë të Izraelit)

Gjyqësori përbën pushtetin e tretë të sistemit të qeverisjes në vendin tonë. Në këndvështrimin e qytetarëve, gjyqësori është pushteti më i rëndësishëm, si gardian dhe mbrojtës i Kushtetutës, zbatimit të ligjit dhe të drejtave të shtetasve. Kjo e bën gjyqësorin më të rëndësishëm në sytë e publikut në raport me dy pushtetet e tjera.

Funksioni i parë dhe më i rëndësishëm i gjyqësorit është të japë drejtësi për njerëzit, kurdoherë ata i drejtohen atij. Njerëzit kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtje nga gjyqësori në rast se të drejtat e tyre shkelen ose rrezikohen të shkelen nga organet e pushtetit publik, subjektet private apo edhe nga vetë individët.

Qytetarët e dëmtuar mund t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar zhdëmtim dhe kompensim. Ata mund të bëjnë të njëjtën gjë kur kanë frikë se mos dëmtohen ose nëse kanë pësuar ndonjë humbje apo dëmtim. Gjykata është gjithashtu institucioni që vendos lidhur me fajësinë ose jo të personave të akuzuar për kryerjen e një vepre penale.

Duke patur në fokus mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtetasve dhe edukimin e tyre ligjor për njohjen dhe ushtrimin e këtyre të drejtave, Komitetit Shqiptar i Helsinkit sjell këtë manual për publikun duke synuar njohjen e disa prej risive më të rëndësishme të sistemit të ri të drejtësisë në vend.

Reforma në sistemin e drejtësisë i jep një formë të re mënyrës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Zbatimi i saj pritet të rikthejë besimin e publikut në organet e drejtësisë. Ky është një proces që para së gjithash kërkon njohjen e publikut në një gjuhë të përshtatshme me ndryshimet kryesore dhe risitë që sjell kjo reformë.



**VETTINGU**  
NJË MASË E JASHTËZAKONSHME  
PËR REFORMIMIN  
E SISTEMIT TË DREJTËSISË

**KAPITULLI**

**I**

# I. VETTINGU – NJË MASË E JASHTËZAKONSHME PËR REFORMIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

## 1. Çfarë është vettingu?

Vettingu përbën një nga risitë dhe komponentët më të rëndësishëm të reformës në drejtësi. Ai është koncept i huazuar nga vende të tjera dhe i përshtatur në legjislacionin e ri të sistemit të drejtësisë, në përputhje me realitetin shqiptar dhe problematikën që synon të zgjidhë. Në të njëjtën kohë, vettingu shqiptar ka synuar të adresojë problematikat e ndeshura nga vende të tjera gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të vettingut në këto shtete. Kjo e bën modelin e vettingut tonë një model krejtësisht unik, me tipare dhe veçori dalluese dhe që ka synuar një shkallë të lartë pajtueshmërie me standartet ndërkombëtare.

Vettingu i referohet rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka si qëllim të garantojë funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë si edhe të rikthejë besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi.

## 2. Përse lindi nevoja për realizimin e vettingut?

Vettingu do të jetë një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme dhe ky vlerësim i është dhënë edhe në mendimet e paraqitura nga Komisioni i Venecias në opinionet e paraqitura gjatë konsultimit të paketës së ndryshimeve kushtetuese për reformimin e sistemit të drejtësisë.

Nevoja për ngritjen e sistemit të vettingut shpjegohet në mënyrë shumë koncize në Opinionin e Ndërmjetëm dhe Final të Komisionit të Venecias për amendamentet kushtetuese të reformës në sistemin e drejtësisë. Në këto opinione vërehet se nevoja për vettingun merr shkas nga niveli ekstremisht i lartë i korrupsionit në gjyqësorin shqiptar. Kjo situatë kërkon marrjen e masave urgjente dhe radikale. Komisioni i Venecias nënvizon se këto zgjidhje radikale nuk do të këshilloheshin në kushte normale, pasi mund të krijojnë tension tepër të madh brenda gjyqësorit. Ndërkohë që në kushtet e Shqipërisë, Komisioni i Venecias e shikon vettingun si një mjet drastik dhe të përshtatshëm, për sa kohë ai mbetet një mjet i jashtëzakonshëm dhe rreptësisht i përkohshëm.



### 3. Si rregullohet procesi i vettingut?

Bazat dhe parimet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkalla e kufizimit të pjeshëm të drejtave kushtetuese, organizimi, funksionimi i institucioneve të rivlerësimit dhe zgjedhja e tyre parashikohet në një aneks të veçantë kushtetues. Ndërkohë me ligj të veçantë, të miratuar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë<sup>1</sup>, parashikohet një rregullim më i detajuar që zberthen akoma më tej dispozitat kushtetuese.

Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

### 4. Kush i nënshtrohet vettingut (subjektet e tij)?

Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit për shkak të funksionit (*ex officio*).

Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen për shkak të funksionit/detyrës (*ex officio*). Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

Çështjet për rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm do të trajtohen me përparësi në kohë nga institucionet e rivlerësimit.

### 5. Mbi çfarë kriteresh kryhet vettingu dhe cilat janë institucionet përgjegjëse që e kryejnë atë?

Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre kriterëve:

- a) vlerësimi i pasurisë;
- b) kontrolli i figures ose i kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;

<sup>1</sup> Ligj Nr 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

c) vlerësimi i aftësive profesionale.

Vettingu kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (Komisioni) në shkallë të parë, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen në shkallë të dytë nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit. Vendimi i Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.

## **6. Cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë funksionarët e lartë të institucioneve të vettingut dhe cili është mandati i tyre?**

Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit kanë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe gjyqtarë të Kolegjit nuk duhet të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit. Kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe funksione drejtuese në partitë politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Këto kërkesa zbatohen edhe për zgjedhjen e komisionerit publik, me përjashtim të kërkesës për përvojën në punë, e cila duhet të jetë jo më pak se 10 vjet.

Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është 5 vite nga data e fillimit të funksionimit tyre, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit është 9 vjet.

## **7. Si përzgjidhen dhe emërohen funksionarët e lartë të institucioneve të vettingut?**

Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të funksionarëve të vettingut është i organizuar në disa faza të cilat përfshijnë institucione të rëndësishme kushtetuese dhe kërkojnë gjithëpërfshirje të forcave parlamentare:

## - Faza 1

Sipas parashikimeve të ligjit, Presidenti i Republikës së Shqipërisë organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të vettingut. Secili prej kandidatëve, bashkë me aplikimin, do të duhet të dorëzojë edhe një deklaratë me shkrim për të autorizuar kontrollin vjetor të pasurisë, monitorimin sistematik të transaksioneve financiare dhe kufizimin e së drejtës për fshehtësi të komunikimeve telefonike gjatë qëndrimit në detyrë.

Presidenti përpilon një listë me kandidatët që kanë shprehur interesin për të aplikuar të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron këtë proces. Nëse Presidenti nuk e përfundon procesin brenda afatit ligjor, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

## - Faza 2

Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët pasi është përmbyllur procesi i përpilimit të listave nga Presidenti ose Avokati i Popullit. Komisioni, bazuar në vlerësimet e tij, i dërgon rekomandimet Presidentit ose Avokatit të Popullit, i cili ia përcjell ato Kuvendit.

## - Faza 3

Me marrjen e listës së kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Kuvendi ngre një komision *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve me gjashtë anëtarë të përbërë nga tre anëtarë të grupeve parlamentare të shumicës dhe tre anëtarë të grupeve parlamentare të pakicës. Komisioni, me të paktën katër vota, mund të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale tek lista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale. Komisioni, me të paktën pesë vota, mund kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tek lista e kandidatëve për votim. Komisioni *ad hoc* i përcjell listën finale të kandidatëve për votim për secilin pozicion dy komisioneve *ad hoc* përzgjedhëse.

#### - Faza 4

Me përmbylljen e fazës së tretë, Kuvendi krijon dy komisione *ad hoc* përzgjedhëse të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, ku një komision ka 12 anëtarë dhe një ka 6 anëtarë.

Secili anëtar i komisionit *ad hoc* me 12 anëtarë përzgjedh një kandidat për komisioner të pavarur të kualifikimit nga lista e kandidatëve për votim pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni përzgjedh më pas dy kandidatë nga lista e kandidatëve për votim për komisionerë publikë përmes një votimi ku dy kandidatët me më shumë vota quhen të përzgjedhur.

Secili anëtar i komisionit *ad hoc*, me 6 anëtarë përzgjedh nga lista e kandidatëve për votim një kandidat për gjyqtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni më pas përzgjedh gjyqtarin e shtatë nga kandidatët e mbetur të listës së kandidatëve për votim përmes një votimi të thjeshtë ku kandidati me më shumë vota quhet i përzgjedhur.

#### - Faza 5

Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga dy komisionet *ad hoc* përzgjedhëse gjatë fazës së 4 përmbliohen në një listë të vetme dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Kuvendi miraton listën e kandidatëve në bllok me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk e miraton listën e kandidatëve në bllok, Kryetari i Kuvendit ia kthen atë komisioneve *ad hoc* për përsëritjen e procesit të përzgjedhjes dhe dërgimin e një liste të dytë. Kuvendi, mund ta rrëzojë në bllok listën e dytë të kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në rast se lista nuk rrëzohet, kandidatët e përzgjedhur konsiderohen të zgjedhur.

### **8. Çfarë është Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe cili është roli i tij në procesin e vettingut?**

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian. ONM do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikqyrjes së gjithë procesit. ONM nuk ka rol vendimmarrës në procesin e vettingut por vëzhgon dhe jep rekomandime.

ONM i ushtron detyrat e veta sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. ONM emëron vëzhguesit ndërkombëtarë nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse.

Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra:

- a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelit dhe Komisionerit Publik;
- b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit si dhe kontribuon për kontrollin e figurës.
- c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim.
- d) kanë të drejtën të marrin të gjithë informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe fazat.

## **9. A mund të kontribuojë publiku gjatë kryerjes së vettingut?**

Çdo person që vihet në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejtë institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim.

Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore si dhe të dhënat mbi identitetin e personit.

Komisioni dhe Kolegji i Apelit publikojnë një model denoncimi me qëllim lehtësimin e paraqitjes së informacionit nga publiku. Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë, mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme sipas standardeve të parashikuara në ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

## 10. Cila është vendimmarrja për subjektet që i nënshtrohen vettingut?

Në përfundim të procesit, organet vendimmarrëse të vettingut (Komisioni ose Kolegji) mund të vendosin për gjyqtarët dhe prokurorët e rivlerësuar si dhe subjektet e tjera që i nënshtrohen këtij procesi:

- a) konfirmimin në detyrë;
- b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës;
- c) shkarkimin nga detyra;

Nëse këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme, ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni ose Kolegji mund të vendosin:

- e) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve;
- f) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

ORGANET E QEVERISJES  
SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

**KAPITULLI**



## II. ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

### 1. Cilat janë organet e reja për qeverisjen e sistemit të Drejtësisë?

Me ndryshimet që pësoi Kushtetuta jonë në 22 Korrik të vitit 2016 si dhe miratimin e ligjit nr.115/2016, organet e reja për qeverisjen e sistemit të drejtësisë janë: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe Shkolla e Magjistraturës.

### 2. Çfarë synon organizimi i ri për qeverisjen e sistemit të drejtësisë?

Nëpërmjet organizimit të ri synohet pavarësia, përgjegjshmëria, transparencja dhe efikasiteti e sistemit të drejtësisë në vend.

**Pavarësia** e sistemit kërkon që gjyqtarët dhe prokurorët të mos jenë subjekt i presioneve apo ndikimeve si dhe të jenë të lirë për të marrë vendime të paanshme bazuar në fakte dhe në ligj.

**Përgjegjshmëria** e sistemit të drejtësisë është e lidhur me vendimmarrjen e pavarur dhe të paanshme të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të cilët duhet të kenë integritet dhe të jenë të pakorrupuar. Me anë të këtij parimi, shoqëria pret nga sistemi i drejtësisë të marrë masa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që shkelin këto vlera apo që shkelin ligjin. Ky parim duhet t'i mundësojë individëve akses në procedurë ankimi të tilla që të rezultojnë në procedim disiplinor për shkeljet e kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët.

**Transparencja** e sistemit të drejtësisë i mundëson qytetarëve të kërkojnë në mënyrë aktive informacion nga institucionet e këtij sistemi. Qytetarët kanë të drejtë të informohen për emërimet dhe shkarkimet në sistemin e drejtësisë, të marrin pjesë në seancat gjyqësore, të kenë akses në vendime gjyqësore dhe akte/dokumente të tjera të cilat nuk përbëjnë sekret hetimor.

**Efikasiteti** është një komponent i rëndësishëm i gjykimit të drejtë dhe mjeteve ligjore efektive. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, mbetet një nga sfidat më të rëndësishme të gjykimit të drejtë, megjithatë kjo nuk duhet të çenojë të drejtat e palëve për t'u përgatitur dhe për t'u mbrojtur në një proces gjyqësor.



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### 3. Çfarë është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe cila është përbërja e tij?

Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucion kushtetues, përgjegjës për pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Shqipëri.

Këshilli i Lartë Gjyqësor zëvendëson me një përbërje tjetër dhe kompetenca të shtuara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor i ushtrojnë funksionet me kohë të plotë.

### 4. Si përzgjidhen anëtarët gjyqtarë dhe jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor?

Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit.

Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Dy anëtarë jogjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës si dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Pas një procedure të detajuar që ndiqet për verifikimin paraprak të kandidatëve jogjyqtarë **për anëtar të KLGJ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit përgatit listat me kandidatët e kualifikuar dhe atyre të skualifikuar dhe ia dërgon Nënkomisionit Parlamentar që ngrihet pranë Komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore.** Pas zgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë, Nënkomisioni i përbërë nga 5 anëtarë, 3 mazhoranca dhe 2 nga radhët e opozitës, i dërgon emrat seancës plenare të Kuvendit për votim.

Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor është 5 vjeçar, me përjashtim të ngritjes për herë të parë të Këshillit, anëtarët e të cilit kanë mandat 3 vjeçar. Anëtari i KLGJ-së mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, ose kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

## **5. Cilat janë risitë që do të sjellë ndryshimi i përbërjes dhe kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor?**

Me ndryshimin e përbërjes dhe kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor synohet të rritet efçensa e këtij organi të vetëqeverisjes së gjyqësorit. Pakësimi i numrit të gjyqtarëve por duke ruajtur shumicën në Këshill, synon të vendosë balancat e duhura dhe të rrisë frymën e kolegjalitetit në vendimarrjen e Këshillit. Përbërja e re e Këshillit synon të shmangë konfliktet e interesit dhe imunitetin ndaj fenomenit të korporatizimit, i njohur ndryshe si mbrojtja e padrejtë që mund t'i bëhet gjyqtarëve nga gjyqtarët kur ata kryejnë shkelje disiplinore. Gjithashtu kjo përbërje synon të shmangë klientelizmin në procesin e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve, i cili në frymën e ligjit, duhet të jetë meritokratik.

Në krahasim me KLD-në e mëparshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk kryesohet nga Presidenti, por nga njëri prej anëtarëve jogjyqtarë që do të emërohet nga vetë radhët e anëtarëve jogjyqtarë. Gjithashtu, në këtë Këshill nuk do të ketë anëtarë për shkak të detyrës si Ministri i Drejtësisë apo Kryetari i Gjykatës së Lartë. Me formulën e re, rritet konkurrenca për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit si dhe synohet t'i jepet fund ndikimeve të padrejta që mund të vijnë nga anëtarë të cilët mbajnë funksione të larta.

## **6. Cilat janë kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor?**

Kompetencat e KLGJ-së në krahasim me ato të KLD-së janë zgjeruar dhe përfshijnë pothuajse të gjitha aspektet e administrimit të gjyqësorit në zbatim të parashikimeve kushtetuese. Sipas dispozitave kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

- c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë sipas ligjit;
- d) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- e) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- f) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;
- g) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- h) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

Këshillit të Lartë Gjyqësor, me ligjin e ri, i janë besuar përgjegjësi të reja, të cilat me sistemin e vjetër të drejtësisë i ka patur Ministria e Drejtësisë. Përkatësisht, Këshilli është përgjegjës për mbajtjen e sistemit statistikor të gjyqësorit, marrëdhëniet e gjyqësorit me publikun dhe mediat, menaxhimin e administratës gjyqësore, administrimin e infrastrukturës fizike dhe të sigurisë, si dhe matjen e performancës së gjykatave.

## **7. Si organizohet Këshilli i Lartë Gjyqësor?**

Me synim rritjen e efikasitetit të Këshillit dhe përmbushjes së objektivave të tij, ligji parashikon organizimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në 4 komisione të përherëshme vendimmarrëse, përkatësisht:

- a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
- b) Komisioni Disiplinor;
- c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;
- d) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

### 8. Çarë është Këshillit i Lartë i Prokurorisë dhe cila është përbërja e tij?

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është institucion kushtetues, përgjegjës për pavarësinë, përgjegjshmërinë, statusin, karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë si dhe mbarëvajtjen e organit të prokurorisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organ kolegjal, i konceptuar me rregulla dhe kompetenca të ngjashme me ato të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe ky institucion përbëhet nga 11 anëtarë me kohë të plotë, gjashtë prej të cilëve prokurorë që zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë. Përbërja e re e Këshillit synon të vendosë balancat e duhura dhe të rrisë frymën e kolegjalitetit në vendimmarrjen e tij duke synuar shmangien e konfliktit të interesit dhe korportazimit gjithashtu.

### 9. Si zgjidhen anëtarët prokurorë dhe jo prokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë?

Gjashtë anëtarë të Këshillit përzgjidhen nga radhët e Prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata zgjidhen sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve joprokurorë është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ata përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Dy anëtarë joprokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Pas një procedure të detajuar që ndiqet për verifikimin paraprak të kandidatëve joprokurorë **për anëtar të KLGJ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit përgatit listat me kandidatët e kualifikuar dhe atyre të skualifikuar dhe** ia dërgon Nënkomisionit Parlamentar që ngrihet pranë Komisionit të përhershëm përgjegjës për

çështjet ligjore. Pas zgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë, Nënkomisioni i përbërë nga 5 anëtarë, 3 mazhoranca dhe 2 nga radhët e opozitës, i dërgon emrat seancës plenare të Kuvendit për votim.

Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është 5 vjeçar, me përjashtim të ngritjes për herë të parë të Këshillit, anëtarët e të cilit kanë mandat 3 vjeçar.

Anëtari i KLP-së mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike ose kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

## **10. Cilat janë risitë që sjell parashikimi i një institucioni të ri qeverisës i prokurorisë?**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka një konceptim tërësisht të ri, në ndryshim nga Këshilli i Prokurorisë së mëparshëm, i cili kishte vetëm rol këshillimor. Me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore, këtij Këshilli i janë dhënë kompetenca vendim-marrëse për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve. Me krijimin dhe funksionimin e Këshillit synohet të ndahen dhe vendosen balancat në ushtrimin e kompetencave në sistemin e prokurorisë, e cila do të ndikojë në rritjen e pavarësisë së brendshme të prokurorëve dhe pavarësisë së jashtme të institucionit.

## **11. Cilat janë kompetencat që ushtron Këshilli i Lartë i Prokurorisë?**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm sipas ligjit;
- d) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikqyr respektimin e tyre;
- e) propozon dhe administron buxhetin e tij;
- f) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- g) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

## **12. Si organizohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë?**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ashtu si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet në të njëjtën mënyrë dhe drejtohet nga një anëtar joprokuror. Ligji parashikon organizimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në 4 komisione të përhershme vendimmarrëse, përkatësisht:

- a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
- b) Komisioni Disiplinor;
- c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;
- d) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

## **INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

### **13. Çfarë është Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe cilat janë kompetencat e tij?**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i ri kushtetues i pavarur, përgjegjës për verifikimin e ankesave të qytetarëve lidhur me gjyqtarët dhe prokurorët. Gjithashtu Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për hetimin me iniciativën e tij të shkeljeve dhe për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve.

Përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë heton shkeljet disiplinore si dhe fillon procedimin disiplinor edhe ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Inspektori kryen gjithashtu inspektime të vetë institucioneve të gjykatave dhe prokurorive.

### **14. Si zgjidhet Inspektori i Lartë i Drejtësisë?**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me shumicë të cilësuar, me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Përrjashtim nga ky rregull bën zgjedhja e Inspektorit të parë të Drejtësisëqë parashikohet të zgjidhet para datës 1 Shtator 2017. Në këtë rast Inspektori i ri zgjidhet me 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga rradhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, person me integritet të lartë moral dhe profesional. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Kuvendi e zgjedh Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe të renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është 9 vjet.

### **15. A vepron parimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë?**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në funksionet e Inspektorit për kryerjen e verifikimeve të ankesave, hetimeve dhe inspektimeve ose në lidhje me ndonjë subjekt të caktuar shkakton përgjegjësi sipas ligjit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përgjegjësi disiplinore sipara parashikimeve të ligjit. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike ose kur është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit hetohen nga një Komision hetimor i Kuvendit.

## **KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

### **16. Çfarë është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe cilat janë kompetencat e tij?**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një organ i ri kushtetues i pavarur, i cili kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për:

- Inspektorin e Lartë të Drejtësisë,
- Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale.

### **17. Si formohet Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe cila është përbërja e tij?**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ kolegjal dhe përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të niveleve të ndryshme duke përfshirë dhe Gjykatën Kushtetuese ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar i cili fillon me datën 01 janar të çdo viti kalendarik. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë.

Midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, Presidenti i Republikës përzgjedh me short dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 05 dhjetor të çdo viti, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik.

Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.



GJYKATA KUSHTETUESE

**KAPITULLI**



### III. GJYKATA KUSHTETUESE

#### 1. Çfarë është Gjykata Kushtetuese dhe cilat janë kompetencat e saj?

Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur kushtetues që ka në kompetencë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimin përfundimtar të Kushtetutës së RSH-së. Gjykata Kushtetuese vendos për:

- a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare;
- b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- d) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- e) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike si dhe të veprimtarisë së tyre;
- f) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
- g) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.
- h) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- i) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që çënon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

## **2. Si formohet Gjykata Kushtetuese dhe cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e saj?**

Gjykata kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë për tu riemëruar përsëri. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë në bazë të një procedure të parashikuar nga ligji përkatës. Për zgjedhjen e anëtarëve nga Kuvendi kërkohet një shumicë e cilësuar prej 3/5-ash.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës. Me qëllim garantimin e parimit të pavarësisë dhe paanësisë, Kushtetuta parashikon se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit.

## **3. Cilat janë risitë që sjellin ndryshimet kushtetuese dhe ligjore lidhur me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese?**

Miratimi i amendamenteve kushtetuese dhe i shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 99/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, dt. 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" vlerësohet se do të sjellë këto risi në raport me përbërjen dhe kompetencat e mëparshme të kësaj gjykate:

- parashikohen kriteret e qarta kushtetuese dhe ligjore për emërimin e gjyqtarëve të kësaj gjykate të cilat synojnë shkallë të lartë meritokracie;
- parashikohet që gjyqtari kushtetues do të ketë përgjegjësi disiplinore në rast të shkeljeve të Kushtetutës dhe të Ligjit duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë së kësaj gjykate.
- synohet mbrojtje dhe garantim efektiv i të drejtave dhe lirive themelore të individit me qëllim që ankimi individual në Gjykatën Kushtetuese të jetë një mjet ligjor efektiv;
- parashikohet përmirësimi i strukturës organizative të GJK-së;

#### **4. Kush gëzon të drejtën për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese?**

Në raport me dispozitat e mëparshme kushtetuese dhe ligjore vihet re se zgjerohet numri i subjekteve të cilët kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Kushtetuese për çështjet që janë objekt i gjykimit kushtetues.

Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.

Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe:

- a) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- b) organet e qeverisjes vendore, kur pretendojnë se u janë cënuar të drejtat e tyre të parashikuara në Kushtetutë ose pozita e tyre kushtetuese;
- c) komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë se ligji ose akti normativ cënon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;
- d) Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cënon veprimtarinë kushtetuese të tyre ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
- e) organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cënon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre;
- f) gjykatat e të gjitha niveleve, kur gjatë gjykimit të një çështjeje konstatojnë se ligji ose akti normativ bie ndesh me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare;
- g) individët, kur pretendojnë se u cënohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejtë i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

Me përjashtim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit, jo më pak se 1/5 së deputetëve dhe Avokatit të Popullit, subjektet e tjera të parashikuara më sipër kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.

## **5. Në cilat raste ushtrohet e drejta e ankimit kushtetues individual?**

**Çdo individ, person fizik ose juridik, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave** dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cënon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

- a) Kërkuesi ka përdorur të gjitha mjetet ligjore efektive të ankimit para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislativi i brendshëm nuk parashikon mjete ligjore efektive në dispozicion të tij/saj;
- b) Kërkesa paraqitet në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit 4 mujor nga konstatimi i cënimit;
- c) Pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin;
- d) Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.

## **6. Si vepron Gjykata Kushtetuese për ankesat për tejzgjatje të procesit?**

Kushdo ka të drejtë të kërkojë shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese nëse pretendon se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm dhe për rrjedhojë atij i janë cënuar të drejtat dhe liritë e tij të parashikuara nga Kushtetuta. Kërkesa për shpërblim kushtëzohet gjithashtu me faktin se subjekti që ngre pretendimin:

- a) është palë në një proces që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese ose,
- b) është palë në një proces gjyqësor të pezulluar si rrjedhojë e një kontrolli incidental ose shqyrtimi të kushtetutshmërisë së ligjit të iniciuar nga subjekte të tjera.

Në çdo rast, pavarësisht pasojave, kërkuesi nuk mund të paraqesë kërkesë pa kaluar të paktën një vit nga fillimi i shqyrtimit të çështjes.

Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese në çdo rast vlerëson natyrën e procesit dhe të çështjes si dhe rrethanat që kanë ndikuar në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese. Ajo vendos për masën e dëmshpërblimit duke iu referuar pasojave që i kanë ardhur kërkuesit nga tejzgjatja e procesit para saj. Nëse Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjykimi është zgjatur tej afatit, pa shkak të arsyeshëm, atëherë ajo dëmshpërblen kërkuesin deri në masën 100.000 lekë për çdo vit vonesë.

## **7. Si mund të mbrohem në gjykimin kushtetues?**

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Kur çështja kalon për gjykim dhe objekt kërkesë është një ligj ose akt normativ, kërkuesi përfaqësohet në gjykim me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar.

## **8. Si shqyrtohen kërkesat në Gjykatën Kushtetuese?**

Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës. Vendimi për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nga Kolegji merret njëzëri. Në rastet kur Gjykata vlerëson se kërkesa është në kompetencën e saj, atëherë i drejtohet subjektit që legjitimohet për të plotësuar kërkesën në rast se nuk është e plotë.

## **9. Kur vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare?**

Kolegji me tre gjyqtarë ka të drejtë të vendosë njëzëri moskalimin e çështjes në seancë plenare kur:

- a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
- b) kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;
- c) kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar;
- d) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
- e) kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t`i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;

- f) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese ose rivendosja në vend e të drejtës së shkelur nuk është e mundur;
- g) kërkesa është haptazi e pabazuar.

## **10. A mundet kërkuesi të heqë dorë nga kërkesa depozituar në Gjykatën Kushtetuese?**

Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë.

Kur Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ka paraqitur kërkesë abuzive ose të përsëritur për të njëjtin shkak ose objekt që është shqyrtuar njëherë, atëherë urdhëron gjobitjen e kërkuesit. Gjoha është titull ekzekutiv dhe shuma e gjobës është nga 100,000 – 500,000 lekë.

## **11. Si shqyrtohen çështjet në seancë plenare në Gjykatën Kushtetuese?**

Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet pasi të jenë depozituar paraprakisht nga palët të gjitha materialet e nevojshme për gjykim si dhe çështja të jetë përgatitur në tërësi nga relatori i çështjes. Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjet në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast jo më pak se të dy të tretat e tyre. Njoftimi për datën dhe orën e zhvillimit të seancës plenare publike bëhet 30 ditë përpara seancës të caktuar.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese thërret dhe drejton seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese. Nëse Kryetari nuk ka mundësi të marrë pjesë në gjykim, ai cakton gjyqtarin më të vjetër në detyrë për të kryesuar seancën. Kryesuesi i seancës plenare ushtron këto detyra:

- a) merr masa për hetimin e plotë dhe të paanshëm të rrethanave të çështjes;
- b) orienton diskutimet mes palëve dhe shmang çdo debat të panevojshëm për çështjen;
- c) ndërpret palët pjesëmarrëse kur diskutimi i tyre nuk ka lidhje me çështjen ose nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese;
- d) u heq të drejtën e fjalës palëve nëse diskutimi i tyre është arbitrar, fyes dhe në kundërshtim me rregullat e etikës dhe moralit.

Seanca, si rregull, zhvillohet pa ndërprerje. Në raste të veçanta, kryesuesi i seancës, pas marrjes së mendimit të anëtarëve të trupit gjykues, mund të ndërpresë seancën kur është e nevojshme.

## **12. Cilat janë të drejtat e pjesëmarrësve në procesin e gjykimit kushtetues?**

Pjesëmarrësit në procesin e gjykimit para Gjykatës Kushtetuese kanë këto të drejta:

- a) të njihen me dokumentet e dosjes dhe të marrin ekstrakte ose fotokopje të tyre;
- b) të marrin pjesë në shqyrtimin e provave;
- c) të paraqesin prova;
- d) t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, dëshmitarëve, ekspertëve dhe specialistëve;
- e) të paraqesin kërkesa;
- f) të japin shpjegime me shkrim ose me gojë;
- g) të paraqesin përfundimet e tyre;
- h) të kundërshtojnë kërkesat e palëve të tjera, përfundimet dhe shpjegimet e tyre si dhe të paraqesin pretendime përfundimtare.

Kërkuesi, në çdo fazë të procesit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë më shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa.



### **13. A ka të drejtë Gjykatë Kushtetuese të pezullojë gjykimin?**

Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të pezullojë shqyrtimin e çështjes nëse gjatë shqyrtimit të saj vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj ose të kërkojë *amicus curia* nga organizma të tjerë.

### **14. Cili është afati i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese?**

Shqyrtimi i çështjeve nga Kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve përfundon brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur ligji organik i kësaj gjykate përcakton afate të tjera. Vendimi përfundimtar shpallet i arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

### **15. Cilat janë efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?**

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Por pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.

Kur Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të një çështje konstaton se ka boshllëk ligjor si rrjedhojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, veç të tjerave, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.

Vendimet e gjykatave të çdo shkalle të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga momenti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i të cilës është shfuqizuar.

Një nga ririsitë e ligjit të ri organik të Gjykatës Kushtetuese është që parashikohet në mënyrë të qartë se moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet penalisht sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.



PUSHTETI GJYQËSOR

KAPITULLI

**IV**

## IV. PUSHTETI GJYQËSOR

### 1. Cilat janë disa nga risitë që synon të sjellë ligji i ri për organizimin e pushtetit gjyqësor?

Ligji i ri synon të garantojë aksesin e qytetarëve në shërbimin gjyqësor, rritjen e shpejtësisë së gjykimit, kontrollin efektiv të shkeljeve ligjore dhe faktike të gjykatave më të ulëta nga ato më të larta, shpërndarjes proporcionale të ngarkesës mesatare të çështjeve për gjykatë dhe gjyqtarë. Gjithashtu, risi tjetër e organizimit të ri gjyqësor është synimi për të patur shtrirje kapilare të shërbimit gjyqësor në të gjithë territorin e banuar të Republikës.

Ligji i ri parashikon rregulla të plota dhe të qarta për gjykatat e të gjitha niveleve në sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur nën ombrellën e këtij organizimi edhe Gjykatën e Lartë, veprimtaria e të cilës me organizimin e vjetër gjyqësor rregullohej me ligj të veçantë. Ligji parashikon me dispozitë referuese se rregullimet specifike për gjykatat e posaçme parashikohen në ligjet e tyre të posaçme (sikurse është ligji për gjykatat administrative apo për institucionet për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar).

### 2. Cilat janë parimet kryesore që udhëheqin organizimin e ri të pushtetit gjyqësor?

**Parimi i aksesit në gjykata** mundëson që gjykata të konceptohet si institucioni ku çdo person duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim. Ky parim kërkon gjithashtu që gjykatat të funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase.

**Parimi i shmangies së konfliktit të interesit** i atribuon nëpunësit civilë gjyqësor detyrimin për të shmangur çdo konflikt interesi në përmbushjen e përgjegjësisë që rrjedhin nga pozicioni i tij/saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave.

**Parimi i bashkëpunimit** kërkon bashkëveprimin, koordinimin dhe bashkërendimin e punës midis këtyre institucioneve/organeve të gjyqësorit, përkatësisht të Këshillit të Lartë Gjyqësor, këshillit të gjykatës, kryetarit të gjykatës, kancelarit, kategorive të ndryshme të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe çdo institucioni tjetër

të përcaktuar me ligj, me qëllim për të garantuar që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur, efikas, i besueshëm dhe transparent.

**Parimet e shërbimit civil gjyqësor**, përfshijnë ndër të tjera parimet e mundësive të barabarta, mos-diskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve efçente dhe të aksesueshme për qytetarët. Statusi i nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor mbështetet në parimin e garantimit të qëndrueshmërisë, bazuar në merita dhe zhvillimin transparent të karrierës.

### **3. Si është i organizuar pushteti gjyqësor?**

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë të cilat krijohen me ligj.

Gjykatat ndahen në gjykata me juridiksion të përgjithshëm dhe ato me juridiksion të posaçëm. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykatat që shqyrtojnë çështjet me karakter civil, tregtar, penal, familjar të cilat nuk shqyrtohen nga gjykatat me juridiksion të posaçëm.

Gjykatat me juridiksion të posaçëm janë gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë dhe të Apelit (të njohura ndryshe si pjesë e SPAK-ut).

Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në rrethe gjyqësore, që është njësi ku funksionon një gjykatë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Një rreth gjyqësor mund të mbulojë një ose më shumë njësi të pushtetit vendor. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe gjykatat e posaçme i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore mbi të paktën dy rrethe gjyqësore.

### **4. Çfarë është harta gjyqësore dhe si miratohet ajo?**

Harta gjyqësore përcakton organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të tyre. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin të vlerësojë në mënyrë periodike hartën gjyqësore, përkatësisht një herë në 5 vjet. Në vlerësimin e hartës mbahen në konsideratë 3 kritere kryesore që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me shtetasit:

**Së pari**, garantimin e aksesit në drejtësi të shtetasve që lidhet me afërsinë e tyre me gjykatën.

**Së dyti**, mbahen në konsideratë kostot me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike. Ky vlerësim do të ndihmojë në menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore dhe atyre infrastruktore.

**Së treti**, mbahet në konsideratë rritja e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara nga gjykata.

Në rast se nga vlerësimi rezulton se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbush objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara në ligj, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave. Përpara se të miratojnë propozimin e përbashkët, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë marrin mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Financave dhe këshillohen me palë të tjera të interesuara.

## 5. Çfarë janë degët e gjykatave?

Me qëllim rritjen e aksesit të publikut edhe kur ndodhen në rrethe të largëta në të cilat nuk ka gjykata në to ose pranë tyre, ligji parashikon garantimin e aksesit nëpërmjet krijimit të degëve të gjykatave.

Nëpërmjet degëve të gjykatave, rritet aksesit të publikut në gjykata, ulet kostoja financiare dhe bëhet një menaxhim më i mirë i burimeve njerëzore dhe atyre financiare si dhe rritja e profesionalizmit. Për këtë arsye në ligj parashikohet se gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm mund të ushtrojë funksionin në një ose disa degët të gjykatës nëse është e nevojshme.

Degët e gjykatave gjykojnë vetëm çështje të cilat nuk janë urgjente si dhe çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Gjykimi i çështjeve tregtare nuk është pjesë e kompetencës së shqyrtimit gjyqësor nga degët e gjykatave.

## 6. Kush mund të jetë gjyqtar dhe nga cili institucion emërohen?

Shtetasit shqiptarë të cilët pasi përfundojnë Shkollën e Magjistraturës dhe pasi krejnë procesin e verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës të tyre, sipas ligjit, emërohen gjyqtarë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Emërimi i tyre bëhet në bazë të parimeve të meritokracisë, transparencës, pavarësisë dhe një sërë kriteresh dhe kushtesh ligjore të mirëpërcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në RSH”.

## **7. A mbajnë përgjegjësi disiplinore gjyqtarët dhe kur mund të shkarkohen ata?**

Gjyqtari, duke përfshirë dhe gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.

Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

- a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;
- b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

## **8. Cilat janë organet drejtuese të një gjykate?**

Në krye të një gjykate zgjidhet kryetari i saj. Në mungesë të kryetarit, kompetencat e tij ushtrohen nga zëvendëskryetari.

Këshilli i Gjykatës është organ tjetër kolegjal dhe vendimmarrës i cili drejtohet nga Kryetari dhe ka gjithashtu në përbërje të tij zëvendëskryetarin dhe kancelarin e të njëjtës gjykatë. Kur Këshilli i Gjykatës vendos për çështje disiplinore të lidhura me nëpunësit civil gjyqësor ose kancelarin, ky i fundit zëvendësohet me një anëtar tjetër sipas parashikimeve të bëra në ligj.

## **9. Cilat janë përgjegjësitë kryesore të kryetarit të Gjykatës dhe Këshillit të Gjykatës?**

Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të tij/saj janë:

- a) përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët;
- b) mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve;

- c) mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre;
- d) udhëzon dhe mbikëqyr kancelarin;
- e) verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelari

Ndër kompetencat më të rëndësishme të Këshillit të Gjykatës janë:

- a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë;
- c) miraton strukturën e gjykatës dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve duke ndjekur rregullat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- d) shqyrton ankesa në lidhje me çështje të infrastrukturës së gjykatës, shërbimet ndihmëse në gjykatë dhe çështje të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e detyrave të administratës gjyqësore;
- e) vlerëson dhe shqyrton projektbuxhetin e përgatitur nga nëpunësi i financës përpara paraqitjes në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- f) organizon rregullisht takime me përdoruesit e gjykatës për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë;
- g) miraton rregulla të veçanta të gjykatës për çështje të ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë;

## **10. Çfarë janë seksionet në gjykata?**

Me qëllim specializimin e gjyqtarëve dhe rritjen e profesionalizmit dhe efektshmërisë në gjykim sipas natyrës dhe llojit të çështjeve, gjykata mund të organizohet në sesione kur kjo është e nevojshme.

Këshilli i Gjykatës mund të krijojë një ose më shumë sesione në gjykatë dhe cakton gjyqtarët në sesione sipas përvojës profesionale dhe fushës së tyre të interesit.



Ata mund të caktohen në sesione civile, penale, tregtare, familjare, etj në bazë të madhësisë së gjykatës. Sesionet e gjykatave përbëhen nga së paku gjashtë gjyqtarë.

### **11. Cili është roli i administratës gjyqësore?**

Administrata gjyqësore realizon shërbime ndihmëse gjyqësore që mbështesin në mënyrë të drejtëpërdrejtë veprimtaritë gjyqësore, si p.sh dokumentimi, veprimtaritë që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryersekretaria dhe sekretarët gjyqësorë.

Administrata gjyqësore gjithashtu kryen shërbime administrative duke përfshirë shërbimet financiare dhe buxhetore, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivën, etj.

Gjithashtu dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse.

### **12. Si funksionon marrëdhënia me publikun në gjykata?**

Shërbimet për marrëdhëniet me publikun funksionojnë si një njësi e veçantë në gjykatë. Këto shërbime kujdesen për informimin e publikut dhe medias lidhur me veprimtarinë e gjykatës dhe çështje të caktuara gjyqësore. Ato i sigurojnë medias dhe publikut:

- a) informacion të detajuar rreth vendimeve gjyqësore;
- b) përmbledhje të vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes për publikun;
- c) informacion mbi seancat gjyqësore për çështje që kanë interes të veçantë publik;
- d) publikimin e të gjitha vendimeve gjyqësore.

Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

### **13. Si organizohet shërbimi për marrëdhëniet me publikun?**

Këshilli i Gjykatës cakton një nëpunës civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator për të drejtën e informimit.

Një gjyqtar i caktuar për marrëdhëniet me publikun do të ushtrojë ose do të mbikqyrë shërbimet për marrëdhëniet me publikun.

### **14. Cilat janë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësore dhe cili është statusi i tyre?**

Me ligjin e ri, statusi i nëpunësve civil gjyqësorë është rregulluar në mënyrë të ngjashme me statusin e nëpunësve civil të administratës publike. Rregullimi i statusit ndikon edhe në krijimin e qëndrueshmërisë, profesionale dhe të rekrutuar në bazë të meritokracisë të nëpunësve civil gjyqësorë.

Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë:

- a) kancelari;
- b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë;
- c) ndihmësi ligjor në Gjykatën e Apelit;
- d) kryesekretari;
- e) sekretari gjyqësor;
- f) nëpunësi i financës dhe buxhetit;
- g) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median.

PROKURORIA

KAPITULLI

V

## V. PROKURORIA

### 1. Si organizohet Prokuroria në Republikën e Shqipërisë?

Prokuroria është organ i pavarur që organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Pranë degëve të gjykatave nuk ngrihen degë të përhershme ose të përkohshme të prokurorisë.

Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- d) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

### 2. Cilat janë ndryshimet që i janë bërë sistemit të prokurorisë në krahasim me sistemin e vjetër?

Organi i Prokurorisë tradicionalisht ka qënë një organ hierarkik dhe i centralizuar, ku prokurori më i lartë jepte urdhëra dhe udhëzime të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Në sistemin e vjetër, Prokurori i Përgjithshëm ishte përgjegjës për karrierën dhe disiplinën e prokurorëve.

Me organizimin e ri, sistemi i prokurorisë synon drejt një shkalle decentralizimi nga pikëpamja procedurale dhe funksionale. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e re ligjore mundësojnë ndarjen dhe balancimin e kompetencave midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, çfarë do të ndikojë në rritjen e pavarësisë së brendshme të prokurorëve dhe pavarësisë së jashtme të institucionit.

### 3. Cilat janë organet drejtuese dhe përfaqësuese të prokurorisë?

Sipas organizimit të ri, drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë bëhet respektivisht nga:

- a) Prokurori i Përgjithshëm;
- b) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
- c) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- d) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

#### **4. Si zgjidhet Prokurori i Përgjithshëm?**

Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me 3/5-at e anëtarëve të Kuvendit, mes 3 kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7 vjeçar. Prokurori i Përgjithshëm i zgjedhur para datës 1 Shtator 2017 zgjidhet me shumicën e 2/3-ave të anëtarëve të Kuvendit.

Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari në listën e tre më të kualifikuarëve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, shpallet i emëruar. Procedura e përzgjedhjes së tre kandidatëve më të mirë për Prokuror të Përgjithshëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazohet në parimet e publicitetit dhe transparencës.

#### **5. Cilat janë përgjegjësitë kryesore të Prokurorit të Përgjithshëm?**

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

- a) Përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme;
- b) Nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme;

- c) siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme.
- d) propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme;
- e) raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit;
- f) ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.

## **6. Kush mund të jetë prokuror dhe cili institucion i emëron?**

Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. Krite të tjera lidhur me kriteret profesionale dhe morale si dhe për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj të posaçëm.

## **7. A janë të pavarur prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre?**

Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitjnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

Prokurorët i nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm, të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.

## **8. Si ruhet konfidencialiteti i të dhënave të çështjeve nga prokuroria?**

Prokurorët dhe gjithë personeli i prokurorisë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si edhe pas përfundimit të saj, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vihen në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Gjithashtu prokurorëve nuk iu lejohej të bëjnë publike ose t'u japin personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi që çenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

## **9. A kanë përgjegjësi disiplinore prokurorët dhe kur mund të shkarkohen ata?**

Prokurori, ashtu si dhe gjyqtari, mban përgjegjësi disiplinore sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm.

Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

- a) kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;
- b) kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.


## **10. Cilat janë kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë?**

Drejtues i prokurorisë është titullari ose drejtuesi i çdo prokurorie, përfshirë Prokurorinë e Posaçme.

Drejtuesi i Prokurorisë përveç kompetencave drejtuese për organizimin dhe funksionin e Prokurorisë, ushtron disa kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale. Konkretisht ai/ajo koordinon veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete, kërkon informacion për ecurinë e procedimeve, jep urdhëra të detyrueshme për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve, verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve, garanton zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të përgjithshëm, etj.

## **11. Si është e organizuar administrata e Prokurorisë?**

Në krye të administratës së Prokurorisë emërohet Kancelari i Prokurorisë i cili ndihmon drejtuesin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve në administrimin



e prokurorisë. Ndërkohë në krye të administratës së Prokurorisë së përgjithshme është Sekretari i përgjithshëm si nëpunësi më i lartë i shërbimit civil.

Administrata e prokurorisë e realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve ndihmëse ndërkohë që administrata e Prokurorisë së Përgjithshme përbëhet nga kabineti, drejtoritë, sektorët përkatës, etj.

## **12. Si është përcaktuar statusi i nëpunësve të administratës së Prokurorive?**

Ashtu si dhe nëpunësit e gjykatave, edhe nëpunësit e administratës së prokurorisë gëzojnë me ligjin e ri të posaçëm, statusin e nëpunësve civil. Nëpërmjet këtij ligji rregullohet statusi i tyre, lidhur me kategoritë e nëpunësve për emërimin, promovimin, transferimet, përfundimi i marrëdhënieve të punës, formimi i tyre profesional, ecuria, përgjegjësia disiplinore, etj.



**INSTITUCIONET  
KUNDËR KORRUPSIONIT  
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**KAPITULLI**

**VI**

## VI. INSTITUCIONET KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

### 1. Çfarë synon legjislacioni që parashikon krijimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar?

Ligji specifik për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar ka si qëllim të garantojë ndëshkueshmërinë e veprave penale në fushën e korrupsionit përmes forcimit të zbulimit dhe hetimit pro-aktiv dhe bashkëpunimit të ngushtë mes strukturave të specializuara antikorrupsion. Ligji parashikon rregullim të detajuar për:

- a) krijimin e një strukture të pavarur e cila të funksionojë sipas parimeve të qëndrueshmërisë, besueshmërisë dhe qartësisë së kompetencave;
- b) statusin e veçantë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, garancitë për përpërzgjedhjen në këto funksione të individëve me integritet të lartë etikomoral dhe profesional si dhe paanshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra;

### 2. Si garantohet krijimi i trupës së hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional në këto institucione?

Ligji parashikon kriteret shtesë nga ato që ligjet e tjera parashikojnë për prokurorët, gjyqtarët e gjykatave të zakonshme dhe oficerët e policisë gjyqësore. Funksionarët e Institucioneve që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë përpara se të emërohen ose punësohen në këto pozicione.

Kandidatët për këto institucione, bashkë me kërkesën për aplikim, dorëzojnë pranë institucioneve që i emërojnë, Deklaratën e Kontrollit të Pasurive të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që provon ligjshmërinë e pasurive dhe Deklaratën e Kontrollit të lidhjeve me krimin (ose siç njihet ndryshe kontrolli i figurës). Ky detyrim shtrihet edhe për anëtarët e afërt të familjes së kandidatit të cilët plotësojnë, nënshkruajnë dhe dorëzojnë një deklaratë me shkrim sipas së cilës nëse kandidati emërohet në detyrë apo punësohet, atëherë telekomunikimet dhe llogaritë bankare të tyre do të jenë objekt vëzhgimi si dhe do të heqin dorë nga e drejta e jetës private lidhur me këto komunikime. Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar,

Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit krijojnë Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit.

Kufizimet e rrepta për oficerët e policisë gjyqësore, hetuesit, prokurorët e gjyqtarët e këtyre institucioneve kanë si qëllim garantimin e krijimit të një trupe me integritet të lartë moral e profesional në këto struktura. Ata do të gëzojnë trajtimin dhe përfitimet e duhura financiare si dhe do të kenë akses të gjërë në bazat e të dhënave të institucioneve, kur këto janë të domosdoshme në ushtrimin e ndjekjes penale.

### **3. Çfarë është kontrolli periodik?**

Kontrolli periodik është një sistem mbikëqyrje dhe kufizimi pasi është kryer emërimi dhe pasi kanë filluar nga puna funksionarët e institucioneve që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sistemi i mbikëqyrjes dhe kufizimeve shtrihet në llogaritë financiare dhe telekomunikimet e këtyre funksionarëve si vijon:

- a) Llogaritë financiare të kryetarëve të gjykatave, të gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, të drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit si edhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Kjo drejtori cakton një punonjës të saj, në konsultim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për të mbikëqyrur llogaritë financiare.
- b) Telekomunikimet e kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit, prokurorëve, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit mbikëqyren në mënyrë periodike. Oficeri përgjegjës në Byronë Kombëtare të Hetimit krijon një plan për shqyrtimin çdo muaj të komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të këtyre funksionarëve. Ky plan nuk u bëhet i ditur kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorëve të posaçëm, Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit apo kujtdo tjetër. Plani ndryshohet çdo tre muaj.

#### **4. Si bashkërendohet veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për kontrollin periodik?**

Oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave bashkërendojnë veprimtaritë e tyre dhe takohen, sipas nevojës, por jo më rrallë se një herë në muaj, për të diskutuar mbi veprimtari të dyshimta.

Oficeri përgjegjës i raporton prokurorit të posaçëm të gatshëm çdo informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm për korrupsion apo veprimtari kriminale. Nëse prokurori i posaçëm duket i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë

#### **5. Çfarë është SPAK-u dhe si është i organizuar?**

SPAK-u është Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar. Kjo strukturë përfshin Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësinë e Posaçme Hetimore e cila emërtohet "Byroja Kombëtare e Hetimit".

Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe Gjykatës së Lartë si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj. Prokuroria e Posaçme i kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e prokurorisë nëpërmjet prokurorëve të posaçëm të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore që heton veprat penale nën drejtimin dhe mbikqyrjen e Prokurorisë së Posaçme sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore.

#### **6. Cila është kompetenca e gjykatës dhe prokurorisë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar?**

Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme

janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në paragrafin e mësipërm.

## **7. Cilat janë detyrimet e organeve të tjera shtetërore në raport me SPAK-un (Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar)?**

Të gjitha organet e pushtetit shtetëror dhe të gjitha subjektet juridike të cilat në kryerjen e aktiviteteve të tyre vihen në dijeni për rrethana dhe të dhëna për vepra penale që janë në kompetencë të SPAK-ut, janë të detyruar t'i referojnë këto rrethana ose të njoftojnë menjëherë strukturat e SPAK-ut. Të gjitha organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me SPAK-un për hetimin e çështjeve penale, sipas legjislacionit në fuqi.

SPAK ka akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale që janë në kompetencë të tij. Organet shtetërore kanë detyrim të japin informacion brenda 24 orëve ose, në qoftë se baza e të dhënave ekziston, t'i japin akses të drejtpërdrejtë Prokurorisë së Posaçme. Ky parashikim nuk zbatohet për sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që janë të çertifikuara si sekret shtetëror. Aksesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.

## **8. Kur do të fillojnë nga puna Institucionet e posaçme për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të Korrupsionit dhe Krimit të organizuar?**

Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara Kushtetutë, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni i kohës përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese.

Ditën kur fillon të funksionojë Prokuroria e Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.

Në mesnatën e ditës së 300-të pas hyrjes në fuqi të ligjit për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, kompetencat e parashikuara në këtë ligj u kalojnë Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe Prokurorisë së Posaçme.

## **9. Cili do të jetë kontributi i ekspertizës ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar?**

Ligji parashikon se Byroja Kombëtare e Hetimit do të asistohet nga një Komision i përbërë nga ekspertë të drejtësisë penale, të caktuar nga misionet e Bashkimit Evropian dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri që do të japë udhëzime dhe këshilla për themelimin dhe zhvillimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit për një periudhë 2 vjeçare duke nisur nga momenti i themelimit të kësaj Byroje.

Ky komision do të vëzhgojë në mënyrë aktive procesin e rekrutimit dhe trajnimit të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe miraton materialet e trajnimit të Hetuesve dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.



